

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

“Stacion Transferimi, Grumbullim, Transport dhe Magazinim i Perkohshem i Mbetjeve Rrezikshme dhe te Parrezikshme”

(Menaxhimi i mbetjeve, pika 5.9 dhe 5.10/b, sipas shtojces 1 te ligjit 52/2020 “Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 te ndryshuar)

Vendodhja: Rruga "Banda Vatra", lagjia 6, Ish NKSH perball fabrikes se tuelles, prona me Nr.Pasurie: 7/61, zona kadastrale 8564, me siperfaqe totale 1493 m².

Kërkues: Subjekti: “KORSEL” sh.p.k



Qershor, 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE

TABELA PËRMBLEDHËSE.....	1
1 TË PERGJITHSHME.....	2
2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT.....	4
2.1 Qëllimi i projektit.....	4
2.2 Të dhëna teknike të aktivitetit.....	4
2.3 Vendodhja e objektit	4
2.4 Lidhja e objektit me infrastrukturën Inxhinierike	6
2.5 Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit	6
2.6 Informacion për shkarkimet në mjedis.....	9
2.7 Presione kryesore të mjedisit në zonën e projektit	10
2.8 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis.....	10
2.9 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	13
2.10 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.....	14
3 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE	15
3.1 Masat Parandaluese	15
3.2 Masat Kontrolluese	15
3.3 Masat Nderhyrëse	16
3.4 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e transferimit të mbetjeve	16
4 PROGRAMI MONITORIMIT.....	18
4.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor	18
4.2 Objektivat e Monitorimit	18
4.3 Plani i monitorimit	18
4.4 Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.	19

1 TË PERGJITHSHME

Subjekti juridik "KORSEL" Sh.p.k me administrator Z. Maksim Fejzulla, është regjistruar në QKR me NUIS, J64104124G për ushtrimin e veprimtarisë në fusha të ndryshme ku përfshihet edhe:

- Pastrim të mjediseve urbane
- Përpunim të mbetjeve urbane në fushat e grumbullimit
- Magazinim seleksionim dhe ruajtje të mbetjeve
- Mirëmbajtje dhe riparim i konteniereve të mbeturinave.
- Larje dhe dezinfektim i konteniereve.

Subjekti "KORSEL" sh.p.k kërkon të zhvillojë aktivitetin në adresën: Rruga "Banda Vatra", lagjia 6, Ish NKSH përball fabrikës së tullës, prona me Nr.Pasurie: 7/61, zona kadastrale 8564, me sipërfaqe totale 1493 m².

Te dhënat e pronës sipas certifikatës së regjistrimit

- Nr.Pasurie 7/61, vëllimi 23, faqe 130, zona kadastrale 8564; Sipërfaqja totale e pasurisë me emërtimin Truall është 1493 m²

Shoqëria "KORSEL" sh.p.k është një subjekt i cili do zhvillojë aktivitetin e tij ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e Menaxhimit të integruar të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Qëllimi i kompanisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave të cilësisë dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e transferimit të mbetjeve.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi nuk përbën shqetësim për banorët, ai ndodhet larg qendrave të banuara. Gjithashtu prona që do të shërbejë për zhvillimin e këtij aktiviteti është pasqyruar në certifikatën e pronësisë të përmendur më lart.

Ky subjekt, si objekt të aktivitetit të tij ka menaxhimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Korçë, si edhe grumbullimin, transportin dhe magazinimin e perkohshëm të mbetjeve të lengshme që do të gjenerohen nga procesi i larjes dhe pastrimit të ambienteve të jashtme të Autoritetit Portual Sarandë me të cilin ka nënshkruar kontratë shërbimi.

Mbetjet urbane transferohen në stacionin e transferimit të mbetjeve ku do të nënshtrohen procesit të selektimit të mbetjeve të cilat do të nënshtrohen procesit të riciklimit si lehtë, plastik, skrap. Ndërsa mbetjet e tjera të vëllimshme të cilat nuk mund të nënshtrohen procesit të riciklimit do të depozitohen në venddepozitim të mbetjeve të qytetit të administruar nga Bashkia Korçë.

Përsa i përket mbetjeve të grumbulluara nga procesi i larjes dhe pastrimit të ambienteve të jashtme të Autoritetit Portual Sarandë destinacioni final i këtyre mbetjeve është shkarkimi i tyre në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur Korçë.


Subjekti, për realizimin e aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij. Ky aktivitet do zhvillohet në përputhje me planin e zhvillimit të zones.

Qëllimi i projektit të propozuar është menaxhimi i mbetjeve urbane te Bashkise Korce, si edhe grumbullimi, transporti dhe magazinimi i perkohshem i mbetjeve te lengshme qe do te gjenerohen nga procesi I larjes dhe pastrimit te ambienteve te jashteme te Autoritetit Portual Sarande duke perdorur automjete te pershtateshme per kryerjen e ketij procesi.

Prona e cituar me siper do të shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit “action transferimi I mbetjeve urbane te parrezikshme” te bashkise Korce si edhe parkimin e autobotit me mbetjet e gjeneruara nga procesi i larjes dhe pastrimit te ambienteve te jashteme te Autoritetit Portual Sarande deri ne momentin qe do te shkarkohet ne impiantin e trajtimit te ujrave te ndotura korce.



Planvendosje e sheshit



Harta topografike e prones

***Koordinatat e prones
(Gauss-Kruger)***

Nr	X	Y
1.	448051 1	4497588
2.	4480529	4497614
3.	4480553	4497597
4.	4480565	4497614
5.	4480576	4497608
6.	4480551	4497569

2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT

2.1 Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit të propozuar është menaxhimi i mbetjeve urbane të Bashkisë Korçë, si edhe grumbullimi, transporti dhe magazinimi i perkohshëm i mbetjeve të lengshme që do të gjenerohen nga procesi i larjes dhe pastrimit të ambienteve të jashtme të Autoritetit Portual Sarandë duke përdorur automjete të përshtatshme për kryerjen e këtij procesi.

Prona e cituar më sipër do të shërbejë për ushtrimin e aktivitetit “action transferimi i mbetjeve urbane të parrezikshme” të bashkisë Korçë si edhe parkimin e autobusit me mbetjet e gjeneruara nga procesi i larjes dhe pastrimit të ambienteve të jashtme të Autoritetit Portual Sarandë deri në momentin që do të shkarkohet në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura korçë.

2.2 Të dhëna teknike të aktivitetit

Subjekti juridik "KORSEL" Sh.p.k me administrator Z. Maksim Fejzulla, është regjistruar në QKR me NUIS, J64104124G për ushtrimin e veprimtarisë në fusha të ndryshme ku përfshihet edhe:

- Pastrim të mjediseve urbane
- Përpunim të mbetjeve urbane në fushat e grumbullimit
- Magazinim seleksionim dhe ruajtje të mbetjeve
- Mirëmbajtje dhe riparim i konteniereve të mbeturinave.
- Larje dhe dezinfektim i konteniereve.

Subjekti "KORSEL" sh.p.k kërkon të zhvillojë aktivitetin në adresën: Rruga "Banda Vatra", agjia 6, Ish NKSH përball fabrikes së tules, prona me Nr.Pasurie: 7/61, zona kadastrale 8564, me sipërfaqe totale 1493 m².

Te dhënat e pronës sipas certifikatës së regjistrimit

- Nr.Pasurie 7/61, vëllimi 23, faqe 130, zona kadastrale 8564; Sipërfaqja totale e pasurisë me emërtimin Truall është 1493 m²

Ky subjekt, si objekt të aktivitetit të tij ka menaxhimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Korçë, si edhe grumbullimin, transportin dhe magazinimin e perkohshëm të mbetjeve të lengshme që do të gjenerohen nga procesi i larjes dhe pastrimit të ambienteve të jashtme të Autoritetit Portual Sarandë me të cilin ka nënshkruar kontratë shërbimi.

Shoqëria "KORSEL" sh.p.k është një subjekt i cili do zhvillojë aktivitetin e tij ekonomik në përputhje me legjislativin në fuqi në fushën e Menaxhimit të integruar të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Subjekti, për realizimin e aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij. Ky aktivitet do zhvillohet në përputhje me planin e zhvillimit të zones.

2.3 Vendodhja e objektit

Aktiviteti në vlerësim ndodhet në rrugën "Banda Vatra", lagjia 6, Ish NKSH përball fabrikes së tules, prona me Nr.Pasurie: 7/61, zona kadastrale 8564, me sipërfaqe totale 1493 m².

Ky shesh do të shërbejë për ushtrimin e aktivitetit "Sacion transferimi i mbetjeve urbane të parrezikshme" të bashkisë Korçë për parkimin e autobusit që do të shërbejë për grumbullimin, transportin dhe magazinimin e perkohshëm të mbetjeve të lengshme që do të gjenerohen nga procesi i larjes dhe pastrimit të ambienteve të jashtme të Autoritetit Portual Sarandë, deri në momentin që do të kryhet shkarkimi i tij në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur Korçë.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi nuk përbën shqetësim për banorët. Gjithashtu sheshi në fjalë i cili do të përdoret për zhvillimin e aktivitetit

ne fjale ndodhet ne brendesi te pronës së me nr pasurie 7/61, zona kadastrale 8564 dhe nuk cenon pronat e tjera perreth.

2.4 Lidhja e objektit me infrastrukturën Inxhinierike

Aktiviteti në vlerësim ndodhet në lagjen 6, Pogradec, ne pronen me numer pasurie 7/61, zona kadastrale 8564, me sipërfaqe 1493 m². Sheshi ku do zhvillohet aktiviteti në fjale ndodhet ne brendesi te prones dhe nuk cenon pronat e tjera perreth.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi nuk përbën shqetësim për banorët. Prona ku do te zhvillohet aktiviteti ne fjale ka infrastructure ekzistuese pasi subjekti Korsel sh.p.k ushtron edhe aktivitete te tjera ne te. Prona aksesohet nepermjet rruges "Banda Vatra".

2.5 Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit

Subjekti "KORSEL" shpk ushtron aktivitetin tregtar prej shume vitesh dhe ka aktive disa kontrata shërbimi lidhur me subjekte private për largimin e mbetjeve nga ambientet ku ato gjenerohen.

Pra subjekti ynë ushtron grumbullim, transport dhe seleksionim mbetjesh te parrezikshme dhe aktivitet e pastrimit dhe larjen me mjet teknologjik te ambienteve te jashtme te Autoritetit Portual Sarande ku perfshihet edhe procesi I pastrimit te njollave te vajit ne keto ambiente. Ky sherbim do te kryhet nje here ne 2 jave ose sa here te jete i nevojshem larja dhe pastrimi i ambienteve te jashtme te Autoritetit Portual Sarande.

Sacioni i Transferimit te Mbetjeve Urbane te Bashkise Korce

Aktiviteti ne shqyrtim ka te bej me mbledhjen nga kontenieret e Mbetjeve Urbane te administruara nga Bahkia Korce dhe transferimin e ketyre mbetjeve ne stacionin e transferimit te mbetjeve me vendodhje ne Kore, Rruga "Banda Vatra", Lagjia 6, Ish NKSH perball fabrikes se tules. Ne kete sipërfaqe subjekti do te zhvilloj edhe procesine selektimit te mbetjeve te cilat do ti nenshtrohen procesit te riciklimit si leter, plastik, skrap. Ndersa mbetjet e tjera te vellimshme te cila nuk mund ti nenshtrohen procesit te riciklimit do te depozitohen ne vendepozitimin e mbetjeve te qytetit te administruar nga Bashkia Korce.

Ne kuader te inisiatives se bashkise korce per seleksionim te burim te mbetjeve ne disa lagje te qytetit firma ka shperndare qese dhe ka vendosur konteniere per seleksionim te mbetjeve te riciklshme dhe organike. Pasi firma grumbullon me mjete te vecanta mbetjet e riciklshme ajo I transporton tek stacioni itransferimit. Prej atje behet nje diferencim I mbetjeve te letres, kartonit, plastikes, metaleve dhe qelqit. Me pas keto mbetje presohen me ane te dy presave vertikale te vendosura ne objekt dhe behen gati per tu transportuar tek fabrikat e riciklimit. Gjithastu biznese te ndryshem te cilet gjenerojne mbetje te riciklshme do te lidhin kontrate me firmen per te seleksionuar mbetjet dhe ne do te bejme transportin per tek stacioni me mjetet tona te cilat jane me logon e riciklimit dhe jane te dallueshem qarte.

Sherbimi qe shoqeria KORSEL shpk duhet te kryej eshte largimi i mbetjeve nga kontenieret e qytetit

dhe transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në stacionin e transferimit të mbetjeve, realizimi i procesit të selektimit dhe me pas mbetjet të cilat nuk i nënshtrohen këtij të fundit do të depozitohen në vendepozitimin e përcaktuar nga Bashkia e Korçës.

Procesi për të cilin është kontraktuar KORSEL shpk konsiston në:

1. Zbrastjen e konteniervave me makina të përshtatshme teknologjike,
2. mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze 10 m nga çdo pike grumbullimi.
3. Vendosja drejtë e konteniervave në pozicion vertikal në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapak të mbyllur.
4. Transporti i imakinave teknologjike në stacionin e transferimit të mbetjeve
5. Realizimi i procesit të selektimit të mbetjeve, të cilat mund të nënshtrohen riciklimit.
6. Depozitimi i mbetjeve të cilat nuk i nënshtrohen procesit të riciklimit, në vendepozitimin e mbetjeve të qytetit të Korçës.
7. Zbrastja e mbetjeve.
8. Pas zbrastjes së konteniervave bëhet dezinfektimi i tyre me gelqere, me 5 % përmbajtje klori, procesi të cilin duhet ta bëjë çdo makine teknologjike.

Grumbullimi, Transporti dhe Magazinimi i Perkohshëm i Mbetjeve të Rrezikshme

Ujrat e ndotura që subjekti grumbullon gjatë një procesi të largës dhe pastrimit në ambientet portuale me Autobotin e tipit MAN me targë TR7102R i dërgon në Impjantin e trajtimit të ujrave të ndotura të Korçës, me të cilin është lidhur Marrëveshja Bashkëpunimi me Ujesjelles Kanalizime të Korçës me.

Për realizimin e aktivitetit subjekti juridik "KORSEL" sh.p.k ka në pronësi mjetin:

- Autobot MAN me targë TR7102R;

Në lidhje me veprimtarinë ID 5.9 Magazinim i perkohshëm i mbetjeve të rrezikshme nga pastrimi i ambienteve portuale, subjekti ka të lidhur një kontratë shërbimi me autoritetin portual të Sarandës sipas të cilit duhet të kryejë largjen dhe pastrimin e ambineteve të jashtme të Autoritetit Portual të Sarandës ku përfshihet edhe pastrimi i njollave të vajit.

Subjekti në rastin e Magazinimit të perkohshëm deri në një javë të mbetjeve të rrezikshme nga ambientet portuale (njolla vaji nga ambientet e jashtme portuale), nuk bën asgjë tjetër përveçse magazinimin në Autobot të mbetjeve të tërhequra derisa mbushet kjo e fundit dhe të vijojë transportimin për destinacionin e përcaktuar në kontratë me autoritetin e Ujesjelles Kanalizime (impianti i trajtimit të ujrave të ndotur të Korçës).

Procesi i largës dhe pastrimit në ambientet të jashtme të Autoritetit Portual të Sarandës kryhet me mjete teknologjike të posaçme dhe me solucion lares. Mbetjet e lengshme të gjeneruara nga procesi i largës së njollave të vajit thithen nga autoboti i cili bën transportin e tyre për në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotur të Korçës.

2.6 Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale. Do të jenë

kryesisht pluhurat nga lëvizja e automjetit (autobotit) dhe zhurmat teknologjike e ketij te fundit në mjediset e punës. Nga ky aktivitet nuk gjenerohen mbetje të ngurta. Mbetjet e gjeneruara janë vetëm mbetjet nga konsumi i përditshëm i puntorëve. Të gjitha mbetjet e grumbulluara do të dërgohen në subjektet e licensuara për trajtimin e tyre dhe të asgjësimit të tyre.

2.7 Ndikimet negative

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Mjedi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jete i ndryshem, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi sheshi është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive të stacionit të transferimit të mbetjeve të tyre. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do vazhdoj të jetë i tillë dhe pas shumë kohësh. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga aktiviteti që ushtrohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për leje mjedisi tipi B. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nën-projektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

Impakti në mjedis nga menaxhimi i tij

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me stacionin e transferimit të mbetjeve gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Shkarkimet në ujë

Zhvillimi i ketij aktiviteti për larjen dhe pastrimin e ambienteve të jashteme të autoritetit portual Sarande, grumbullimin, transportin dhe shkarkimi (mbetjet e lengshme nga procesi i larjes) në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotur Korce, nuk gjeneron shkarkime të ujrave të ndotur. Kjo për faktin se subjekti përveç proceseve të mesiperme nuk bene trajtimin apo asgjësimin e sasise të mbetjeve që ka grumbulluar gjatë procesit të larjes së ambienteve të jashteme të Autoritetit Portual Sarande.

Emëtimet në ajër

Ndotja e ajrit vjen si rezultat i përhapjes së pluhurave që gjenerohen nga lëvizja e autobotit si edhe clirimi i gazrave të lëndëve djegësë. Duhet theksuar se aktiviteti i përditshëm urban i automjeteve gjeneron ndotje më të madhe se sa përdorimi i mjeteve në sheshin ku do të zhvillohet aktiviteti.

Emetimet e zhurmave dhe gazeve të makinave te transportit në mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë procesit te transportit, duhet theksuar se ky ndikim është i minimizuar.

Ndërkohë Udhëzimi nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara", përcakton vlerat e lejuara të zhurmës si në tabelën e mëposhtme.

Nivelet kufi të zhurmës në mjedise të caktuara

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	LAmx Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, Qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110

Shpjegime:

LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A
Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja

LAmx Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën Fast (e shpejtë)

1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur

2 = Presioni zanor maksimal (LAmx, fast) matur 100 mm larg veshit

3 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me

4

zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur

4 = *Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë*

Ndikimet në tokë

Ndikimet në tokë do të jenë minimale, kjo për vetë faktin se nuk kemi shkarkim të autobotit në prone por vetëm parkim të tijë deri në momentin që do të shkarkohet në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotur Korce.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhvillimi i këtij aktiviteti për larjen dhe pastrimin e ambienteve të jashteme të autoritetit portual Sarandë, grumbullimin, transportin dhe shkarkimi (mbetjet e lengshme nga procesi i larjes) në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotur Korce, do të shoqerohet me gjenerim të zhurmave që vijnë vetëm nga automjetet që subjekti do të përdorë për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Zhurmat që do të gjenerohen nga automjetet janë standart të teknologjisë së tyre dhe nuk do të jenë të vazhdueshme. Zhurmat do të ndjehen vetëm në momentin e ardhjes së automjeteve dhe largimit të tyre nga vendi i ushtrimit të aktivitetit. Koha e qenderimit të tyre ndezur është relativisht e ulët.

Ndikimet në florë/faunë

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zonës në fjalë, pasi kjo zonë është shumë e varfër me bimësi, gjithashtu zona ku do ushtrohet aktiviteti do të jetë e shtruar me beton/armë dhe me cakull, si dhe e rrethuar përgjatë gjithë perimetrit të sajë.

Mbetjet e prodhuara

Proceset që do të zhvillohen nga veprimtaria për larjen dhe pastrimin e ambienteve të jashteme të autoritetit portual Sarandë, grumbullimin, transportin dhe shkarkimi (mbetjet e lengshme nga procesi i larjes) në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotur Korce, do të gjenerojë mbetje të lengshme të cilat pas përfundimit të procesit të larjes dhe pastrimit do të thithen nga autoboti. Destinacioni final i mbetjeve të lengshme është shkarkimi i tyre në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotur Korce.

Ndërsa mbetje që do të gjenerohen nga punonjësit janë mbetje urbane të cilat do të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore, gjithashtu duke parë infrastrukturën e dobët të menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën ku do të zhvillohet veprimtaria, shoqëria ka parashikuar instalimin e kontenerëve me qëllim diferencimin e mbetjeve që në burim.

2.8 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve

Toka / Përdorimi i Tokës

Kryerja e aktivitetit brenda sipërfaqes së kërkuar për zhvillimin e aktivitetit. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.

Erozioni / Mbrojtja nga erozioni

Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e instalimit për ruajtjen/magazinimin transferimin e mbetjeve. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave të shiut. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të sipërfaqes së objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirëmbajtja e bazamentit ku do të zhvillohet aktiviteti.

Biodiversiteti / Vegjetacioni, Dëmtim potencial i vegjetacionit

Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidanëve të rinj, kryesisht përgjatë rrugës që bën të mundur hyrjen për në objekt, si dhe në kufirin kufizues të pronës ku do zhvillohet aktiviteti.

Cilësia e ajrit / Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i instalimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit

Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtës. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezervë brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i stacionit të transferimit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.

Sistemi i drenazhimit

Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujërave të shiut nga pastrimi përgjatë gjithë gjatësisë së sipërfaqes së aktivitetit, bashkimi i tyre në një vaskë dekantimi, para se ato të derdhen në rrjetin e ujërave të zonës.

Mbetjet / Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në aktivitet.

Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore.

Zhurmat / Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve

Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.

Trafiku Rrugor / Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve

Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtësisë, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

2.9 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.

- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të këtu ndikime në ndryshimin e habitateve
- Magazinim/ruajtje, transferim
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazane të vecante. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore për mbetjet urbane.
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.
- Mbetjet urbane të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Njësia Vendore.
- Janë marrë masa për ndriçimin përreth (vendosja e impiantit të ndriçimit).
- Shoqëria operon në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe duke qenë aktiviteti egzistues kryen monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisore të trysnise në mjedis.
- Janë marrë masa në projekt për instalimin dhe respektimin e sinjalistikës e trafikut të cilat do të minimizojnë impaktet për aksidente të mundshme.
- Për të minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, do të limitohen proceset e zhurmshme gjatë orëve me të ndjeshme, ndërmjet orës 20⁰⁰ e mëtej deri në 07⁰⁰ të mëngjesit.
- Do të respektohen të gjitha kushtet dhe masat në Lejen e Mjedisit që do të vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vlerësimet e mesipërme, shkarkimet e pritshme në mjedis janë të ulëta dhe nuk përbejnë problem serioz për mjedisin. Megjithatë përparësitë që ka ky aktivitet, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

3 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në ruajtjen/magazinim, transferimin, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO2, NOx, SOx në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë efikente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti “**KORSEL**” Sh.p.k, ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme:

3.1 Masat Parandaluese

- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë magazinimit/ruajtjes, transportimit transferimit të mbetjeve.
- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.
- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.
- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i ruajtjes/magazinimit transferimit të mbetjeve.
- Mbajtja gjithmone fikur e automjeteve kur nuk është e nevojshme përdorimi i tyre dhe ruajtja e distancës së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit;
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si : doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundra gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit.
- Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhjesh të lubrifikantëve dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimin e tyre përfundimtar nga kompanit e nënkontraktuar.
- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundra ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike të larjes dhe të shiut, si dhe mirëmbajtja e pemëve.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit
- Monitorimi periodik i parametrevë mjedisore dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.

3.2 Masat Kontrolluese

- Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike
- Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.
- Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.
- Vëzhgimi dhe kolaudimi i vazhdueshëm i të gjithë makinerive të transportit.
- Diferencimi i mbetjeve sipas rrymave specifike që gjenerohen
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
- Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

3.3 Masat Nderhyrese

- Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/makinerive nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.
- Kapja, asgjësimi i menjehershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjehershëm i ambientit të punës me detërgjentë të posaçëm, që mund të gjenerohen nga veprimtaria dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.
- Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/ makinerive dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.
- Riparimi i menjehershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.
- Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.
- Njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme.
- Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.
- Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).
- Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim.

3.4 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e transferimit të mbetjeve:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.

- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i plotë objektit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga stacioni i transferimit.
- Është detyrë e zhvilluesve të aktivitetit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së ruajtjes/magazinimit, transferimit të mbetjeve të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për ruajtjen/magazinimin, transferimin e mbetjeve vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së sheshit të marre me qira.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin zonave përreth.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të transferimit të mbetjeve
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve dhe asgjësimi i tyre nga operator telicencuar.
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të ambalazheve, letra- kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto

mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.

- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjediseve të gjebëruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjëlberuar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Eshte ndertuar sistemi i drenazhimit te ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në instalimin për ruajtjen/magazininimin transferimin e mbetjeve.

4 PROGRAMI MONITORIMIT

4.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

4.2 Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të tij.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e funksionimit të aktivitetit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet stacioni i transferimit të mbetjeve dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

4.3 Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime për transferimin e mbetjeve, i pozicionuar ne Zona Industriale, Spitalle, Durres nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në sheshin e transferimit por dhe në një zonë mbi 50 m për rreth sheshit ku do te zhvillohet aktiviteti.

Plani i monitorimit do të konsistojë në:

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të instalimit.
- Monitorimi i zonës së mundëshme të gjenerimit te aromave gjate zhvillimit te veprimtarise
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve te gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura ne sipërfaqen e aktivitetit nen dikimin e reshjeve te shiut.
- Monitorimi I sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale e mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka demtime merren masa për zëvendësime dhe fidanë të rinj. Monitorimi I çdo sipërfaqe të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjecare, kohë gjatë së cilës bimët kanë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë më nevojë për shërbime.

4.4 Plani i monitorimit te ndikimit ne mjedis.

Do te kryhet monitorimi I pluhurave, i zhurmës cilesise se ujrave megjithëse ne kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

Nr	Elementii Monitorimit	Frekuenca	Analiza	Përgjegjësi
1	Monitorim i gjithë shkarkimeve të ujrave që shkarkohen nga instalimi	Periodike Parametrat	Analize e plote. kimike: nitrate, nitrite, BOD, COD, metale, hidrokarbure. Aromat, temperature, pluhurat,	Firma Firma
2	Monitorim i shkarkimit të grimcave të pluhurit, gazrave gjatë magazinimit/ruajtjes, transferimit te mbetjeve.	Vazhdueshëm	Ne pika te ndryshme te stacionit te transferimit dhe rikuperimit SOx, CO, CO2	
3	Monitorim i gazeve nga mjetet e transportit		mekanikës dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë.	
4	Monitorim i gjendjes së	5	monitorimin e mbjelljes së kurorës së pemëve	

6	Sasia e mbetjeve te magazinuara/ruajt ur	vazhdueshem NOx, SOx, CO, CO2, O etj	Firma Vazhdueshem Zhurmat dB(A) Firma
		Periodike	sasiore Firma
		Periodike	Sasiore Firma
7	Sasia e mbetjeve te transferuara	Vazhdueshem	Sasiore Firma

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron funksionimi I ketij aktiviteti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të instalimit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.

Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderushëm dhe nuk kanë nevojë përshërbim.